

CT 76

SOLAR PROTECT

Suvë siliko-elastike, strukturë si gur

Granulacioni 1,5 mm ose 2,0 mm

Suva dekorative përfundimtare me shtresë të hollë,
me mbrojtje të rritur ndaj UV rrezeve për përdorim të
brendshëm dhe të jashtëm

KARAKTERISTIKAT

- Rezistencë e lartë ndaj rrezatimit UV
- Qëndrueshmëri e sipërfaqes me efekt vetë-rigjenerues
- Stabilitet i lartë i ngjyrës
- Efekt vetë-pastrues (rezistencë ndaj ndotjes)
- Elastik dhe rezistent ndaj goditjeve
- Thithje shumë e ulët dhe përkushueshmëri e lartë e avullit
- Rezistent ndaj kushteve të ndryshme atmosferike
- Gamë shumë e gjerë nuancash Ceresit Colours of Nature® & Intense
- Afat i zgjatur i ruajtjes



FUSHA E APLIKIMIT

Ceresit CT 76 përdoret për realizimin e suvave dekorative me shtresë të hollë në sistemet e termoizolimit të jashtëm, në nënshtresa betoni, suva tradicionale, nënshtresa gipsi, pllaka druri të shtypur (chipboard), pllaka gips-kartoni etj.

Rekomandohet përdorimi i suvasë Ceresit CT 76 si suva fasade në kuadër të sistemit Ceresit ETICS (sistemi i termoizolimit të jashtëm), me pllaka EPS dhe lesh mineral. Ceresit CT 76 rekomandohet për sipërfaqe ku kërkohet përkushueshmëri e lartë e avullit. Falë aditivëve dhe mbushësve specialë, ajo ka aftësi të vetë-rigjenerimit të mikroçarjeve në sipërfaqe. Sasia e shtuar e absorbuesve UV siguron qëndrueshmëri të shkëlqyer të ngjyrës ndaj dritës.

PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Ceresit CT 76 mund të aplikohet në nënshtresa të rrafshëta, mbajtëse, të thata dhe të pastra, pa yndyrë, bitum, pluhur dhe substanca të tjera që ulin ngjitjen:

- suva çimento dhe çimento-gëlqere (më të vjetra se 28 ditë)
- beton (më i vjetër se 3 muaj, lagështia ≤ 4%), i trajtuar me veshjen bazë Ceresit CT 16
- suva të suvatuara, të lyera me primer Ceresit CT 16 (të vjetra mbi 3 ditë)
- nënshtresa gipsi (vetëm brenda objekteve), me lagështi nën 1%, të trajtuara më parë me veshjen bazë Ceresit CT 17 dhe më pas me Ceresit CT 16
- pllaka druri të shtypur (iverice), pllaka gips-fibër dhe gips-kartoni (vetëm brenda objekteve), të fiksuara sipas rekomandimeve të prodhuesit të pllakave, të trajtuara paraprakisht me veshjen bazë Ceresit CT 17 dhe më pas me veshjen bazë Ceresit CT 16
- veshje të forta bojërash (vetëm brenda objekteve), me ngjitje të mirë në nënshtresë, të trajtuara me veshjen bazë Ceresit CT 16

Sipërfaqet e parregullta dhe të dëmtuara duhet të rrafshohen dhe riparohen paraprakisht. Në rastin e suvasë tradicionale dhe nënshtresave prej betoni mund të përdoret masa niveluese Ceresit CS 70. Ndotjet ekzistuese, shtresat me rezistencë të ulët, si dhe veshjet elastike, gëlqerore dhe bojërat ngjitëse duhet të hiqen. Nënshtresat thithëse duhet të trajtohen fillimisht me primer bazë Ceresit CT 17, dhe më pas, pas të paktën 2 orësh, me primer bazë Ceresit CT 16. Rekomandohet që ngjyra e primerit Ceresit CT 16 të jetë sa më afër ngjyrës së suvasë. Ceresit CT 76 mund të aplikohet vetëm kur primeri bazë Ceresit CT 16 është tharë plotësisht. Lagështia nga nënshtresa mund të shkaktojë dëmtim të suvasë, prandaj duhet të sigurohen shtresa të përshtatshme hidroizoluese në hapësirat dhe zonat e ekspozuara ndaj lagështisë së vazhdueshme.

Ceresit

#NDËRTOJMËSËBASHKU



APLIKIMI

E gjithë përmbajtja e kovës duhet të përzihet me kujdes. Nëse është e nevojshme, mund të shtohet maksimumi 1% ujë i pastër dhe të përzihet sërish. Nuk duhet të përdoren enë apo mjete të ndryshkura. Ceresit CT 76 duhet të aplikohet në mënyrë të njëtrajtshme në nënshtresë në trashësinë e kokrrizës, duke përdorur mistri çeliku dhe duke e mbajtur mjetin në kënd. Më pas, me mistri plastike të vendosur rrafsh mbi sipërfaqe, me lëvizje rrethore formohet një strukturë homogjene me pamje të kokrrizave të agregatit të shpërndara në mënyrë të dendur.

Mos e spërkatni suvan me ujë!

Punimet duhet të kryhen në një sipërfaqe të vetme pa ndërprerje, duke ruajtur të njëjtën konsistencë të produktit. Nëse puna duhet të ndërpritet, përgjatë vijës së përcaktuar paraprakisht duhet të ngjitet shirit vetëngjitës. Pastaj aplikohet suvaja, formohet struktura dhe shiriti hiqet së bashku me materialin e tepërt që ka mbetur mbi të. Pas pauzës, aplikimi vazhdohet nga pika e shënuar. Skaji i suvasë së aplikuar më parë mund të mbrohet me shirit vetëngjitës. Veglat dhe njollat e freskëta të suvasë duhet të lahen me ujë. Mbetjet e ngurtësuar të suvasë mund të hiqen mekanikisht. Rinovimi i suvasë bëhet me lyerje me bojë silikoni Ceresit CT 48.

SHËNIM

Aplikimi duhet të kryhet në temperaturë të ajrit dhe të nënshtresës nga +5 deri në +25 °C dhe me lagështi relative të ajrit nën 80%.

Ky produkt nuk duhet të përzihet me suva të tjera, pigmente, rrëshira apo lidhës. Hapësirat ku është aplikuar materiali duhet të ajrosen derisa era të zhduket dhe para përdorimit të tyre. Në rast kontakti me sytë, ato duhet të shpëlahen me ujë dhe të kërkohet ndihmë mjekësore. Produkti duhet të ruhet jashtë mundësisë së fëmijëve. Karakteristikat e performancës janë të dhëna në tekstin e Deklaratës së Performancës.

INFORMATAT TË TJERA

Suvaja nuk duhet të aplikohet në mure të ekspozuara ndaj diellit të fortë dhe duhet të mbrohet nga tharja e shpejtë. Deri në tharjen e plotë, duhet të mbrohet nga shiu. Rekomandohet përdorimi i mbrojtjes në skelë.



Për shkak të mbushësve mineralë në suva, të cilët mund të shkaktojnë dallime në ngjyrë, një sipërfaqe duhet të suvatohet me material nga e njëjta seri prodhimi, numri i së cilës është i shtypur në çdo kovë. Për të siguruar strukturë të njëtrajtshme të suvasë, duhet të sigurohet numër i mjaftueshëm punëtorësh në nivele të ndryshme të skelës dhe sipërfaqet e punës të lidhen me teknikën "e lagët mbi të lagët". Kova e hapur duhet të mbyllet me kujdes dhe përmbajtja të përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme.

PAKETIMI

Kovë plastike prej 25 kg.

Përveç informacioneve të dhëna këtu, është e rëndësishme të respektohen udhëzimet dhe rregulloret përkatëse të organizatave dhe shoqatave profesionale, si dhe standardet përkatëse të Institutit Gjerman për Standardizim (DIN). Karakteristikat e dhëna bazohen në përvijë praktike dhe në testime të kryera. Vetitë e garantuara dhe përdorimet e mundshme që tejkalojnë ato të përmendura në këtë fletë teknike kërkojnë konfirmimin tonë me shkrim. Të gjitha të dhënat janë marrë në temperaturë ambiente dhe materiali prej +23 °C dhe lagështi relative të ajrit 50%, përveç nëse është shënuar ndryshe. Kini parasysh se në kushte të ndryshme klimatike procesi i ngurtësimit mund të përshpejtohet ose të ngadalësohet.

Informacionet e përmbajtura në këtë dokument, veçanërisht rekomandimet për trajtimin dhe përdorimin e produkteve tona, bazohen në përvijë tonë profesionale. Duke qenë se materialet dhe kushtet mund të ndryshojnë në varësi të çdo aplikimi të synuar dhe janë jashtë fushës sonë të ndikimit, rekomandohet fuqimisht që në çdo rast të kryhet një numër i mjaftueshëm testimesh për të verifikuar përshtatshmërinë e produkteve tona për përdorimin e parashikuar. Përgjegjësia ligjore nuk mund të pranohet në bazë të përmbajtjes së kësaj flete teknike apo ndonjë këshille verbale, përveç në rastet e veprimit të qëllimshëm ose neglizhencës së rëndë nga ana jonë. Kjo fletë teknike zëvendëson të gjitha botimet e mëparshme që lidhen me këtë produkt.

TË DHËNAT TEKNIKE

Përbërja	shpërndarje ujore e rrëshirave silikone dhe akrilike me mbushës mineralë dhe pigmente
Dendësia:	1,7 kg/dm³
Temperatura e aplikimit:	nga +5 °C deri në +25 °C
Koha e tharjes:	rreth 15 min.
Rezistenca ndaj shiut:	nga 24 deri në 48 orë, në varësi të temperaturës.
Përshkueshmëria e avullit:	V1 sipas EN 15824
Thithja e ujit:	W3 sipas EN 15824
Ngjithshmëria:	0,6 MPa sipas EN 15824
Përçueshmëria termike:	$\lambda=0,61 \text{ W/(m}^{\circ}\text{K)}$ sipas EN 15824
Rezistenca ndaj goditjeve:	kat. II sipas ETAG 004
Thithja e ujit pas 24 orësh:	< 0,5 kg/m² sipas ETAG 004
Përshkueshmëria e avullit:	Sd ≤ 1,0 m sipas ETAG 004
Ngjithja ndërmjet shtresave pas plakjes:	≥ 0,08 MPa sipas ETAG 004
Klasifikimi i reagimit ndaj zjarrit sipas EN 13501-1:	B - s1, d0 u:
Ceresit Ceretherm Popular Ceresit Ceretherm Classic Ceresit Ceretherm Wool Classic Ceresit Ceretherm Universal EPS A2-s1, d0 në: Ceresit Ceretherm Universal MW	
Rezistenca ndaj zhvillimit të mykut:	rezistenca e plotë
Konsumi mesatar:	Ceresit CT 76 granulacioni 1,5 mm: nga 2,1 deri në 2,5 kg/m² Ceresit CT 76 granulacioni 2,0 mm: nga 3,1 deri në 3,4 kg/m²


Ky produkt posedon:

European Technical Approval (ETA) në sistemet:

Ceresit Ceretherm System	Popular	Classic	Classic Wool	Universal EPS	Universal MW
ETA	08/0309	09/0014	09/0026	13/0535	14/0127
Certificate	1488-CPR0382/Z	1488-CPR0439/Z	1488-CPR0440/Z	1488-CPR0457/Z	1488-CPR0362/Z
DoP	00426	00420	00424	00433	00435



Degradimi i lidhjeve polimerike



Ceresit CT 76 - efekti i vetë-rigjenerimit

Për qëndrueshmërinë e fasadës dhe për të parandaluar mbinxhjen e tepër të sipërfaqes së fasadës, rekomandohet përdorimi i suvasë Ceresit CT 76 me vlerë reflektimi të dritës HBW ≥ 15. Në rast të përdorimit të suvasë me vlerë HBW nën 15, rekomandohet konsultimi me departamentin teknik të Ceresit për zgjedhjen e sistemit të përshtatshëm të termoizolimit. Ceresit CT 76 është e mbrojtur nga ndikimet biologjike, p.sh. kërpudhat, myku dhe algat, duke rritur rezistencën e saj ndaj veprimit të tyre.



Suva të tjera pas viteve të përdorimit



Ceresit CT 76 pas viteve të përdorimit

MAGAZINIMI

Deri në 18 muaj nga data e prodhimit, nëse ruhet në kushte të thata dhe të freskëta, në paketimin origjinal të padëmtuar.

Të mbrohet nga ngrica dhe rrezatimi i drejtpërdrejtë i diellit!



* according to Cradle to Gate analysis from cement producer. More info on www.ceresit.com

Henkel CEE
www.ceresit.al

